



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 nr.11-80

18.03.2022

SH k u p

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 pika 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 i të njëjtit Ligj, pika 8 nga Rregullorja për përcaktimin e afatit të veprimit sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kontrollit të kryer ark.nr.11-989/1 nga 14.03.2022 dhe Konkluzionin ark.6p.02-1036/3 nga 18.03.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 11-të, e mbajtur më 18.03.2022, miratoi si në vijim:

Vendim

për vërejtje publike dhe për çkyçjen e riemitimit të serviseve programore

- PUBLIKISHT U PARALAJMËRUA** Operatori i rrjetit të komunikimit elektronik, Shoqëria tregtare për prodhimtari, tregti dhe shërbim (SHPTSH) ALTRA – SAT 2000 SHPKPV Ohër, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtueshmëri me nenin 141 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.
Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-989/1 nga 14.03.2022, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.
- DETYROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik TDPTU ALTRA – SAT 2000 SHPKPV Ohër, menjëherë pas marrjes së vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, dmth të revokoj ritransmetimin e shërbimeve programore.
- Të kryhet mbikëqyrje e kontrolluar, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ka vepruar sipas vendimit vërejtje publike për revokimin e ritransmetimit të shërbimeve programore.
- Derisa subjekti i mbikëqyrur i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, nuk vepron sipas vendimit pra vazhdon të kryejë shkelje për të cilat i është tërhequr vërejtje publike, Agjencioni për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 pika 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtje pranë gjykatës kompetente.
- Ky vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita kur verifikikohet në arkivën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencia) në pajtueshmëri me nenin 6 paragrafi 1 pika 4 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV) ndërroi masa në pajtueshmëri me këtë ligj në raste kur ka shkelje të dispozitivit nga LSHMAAV ose të rregullores e miratuar në bazë të saj dhe kushteteve dhe detyrimeve për leje.

Në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV, Agjencia ka kompetenca të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve në transmetim dhe dhënësve të shërbimeve audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të normave nga ky ligj, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në kornizat e kompetencave të saja ligjore, në pajtueshmëri me nenin 27 dhe nenin 28 nga LSHMAAV, Agjencioni më 11.03.2022., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të shërbimeve programore të ritransmetuara nga ana e operatorëve TDPTU ALTRA – SAT 2000 SHPKPV Ohër ku u konstatua se operatori në fjalë ku sipas njoftimit nga Agjencioni për komunikim elektronik mund ta kryejë veprimtarinë në territorin e komunës Ohër, më 10.03.2022. ku për shfrytëzuesit e tij ritransmeton shërbime programore që nuk janë të përfshira në çertifikatën e regjistrimit të shërbimeve programore të dhëna nga Agjencia, që bie në kundërshtim me nenin 141 nga LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.11-989/1 nga 14.03.2022., që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

Për rrjedhojë, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 pika 20 dhe neni 23 paragrafi 1 pika 1 nga LSHMAAV, dhe në bazë të nenit 141 paragrafi 13 nga i njëjti Ligj, pika 8 nga Rregullorja për përcaktimin e afatit të procedurës sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje e kryer programore ark.nr.11-989/1 nga 14.03.2022., dhe Konkluzionin ark.nr.02-1036/3 nga 18.03.2022., për shkak të konstatimit për shkelje të dispozitave nga LSHMAAV të përcaktuara në pikën 1. të këtij vendim, Këshilli i Agjencisë, solli vendim me të cilin ndaj subjektit në fjalë u sollë masë vërejtje publike dhe obligohet që menjëherë pas pranimit të vendimit të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore dhe të harmonizojë punën e tij në bazë të dispozitave nga LSHMAAV, në mënyrë që të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i përmendur ka vepruar sipas vendimit, dmth pas vërejtjes publike të ndaloi ritransmetimin e shërbimeve programore.

Në pajtueshmëri me nenin 24 nga LSHMAAV, ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa u tha më lartë, u soll vendimi si në dispozitiv.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për shërbime
Mediatike audio dhe audiovizuele,
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për të inicuar kontestin administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ dorëzohet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit. против ова решение операторот на јавна електронска комуникациска мрежа може да поднесе тужба за поведување на управен спор пред надлежен суд. Тужбата за поведување на управен спор се поднесува во рок од 30 дена од денот на приемот на решението.

Shtojca (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kontrollit programor, ark.nr.11-989/1 nga 14.03.2022.